



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEË BODY

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEË BODY

NPR
Dati / Datum
122/17
30.05.17
PRISHTINE - PRISTINA

PSH. nr. 122/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT PUBLIK i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 si dhe nenit 106 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, dhe nenit 26 paragrafi 1 i Rregullores së Punës së OSHP-së, në përbërje **Ekrem Salihu-Kryetar, Tefik Sylejmani – Referues, Nuhi Paçarizi-Anëtar, Goran Milenković- Anëtar dhe Blerim Dina-Anëtar**, duke vodusur sipas ankesës me nr. të protokollit 122/17, të parashtruar nga grapi i operatorëve ekonomik “Selmans Network”sh.p.k. Prishtinë & OE“Krasniqi”sh.p.k. Prishtinë & OE“Schafberger gmbh”Drenas & OE NTP “Beni” Suharekë & OE “Aroma Plus”sh.p.k. Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Mirëmbajta e të gjitha objekteve Komunale dhe sigurimi i tyre**”, me nr. të prokurimit: 635/17/038/215, të shpallur nga autoriteti kontraktues– Komuna e Pejës, në seancën e dt. 24 maj 2017, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet**, ankesa e grupit të operatorëve ekonomik “Selmans Network”sh.p.k. Prishtinë & OE“Krasniqi”sh.p.k. Prishtinë & OE“Schafberger gmbh”Drenas & OE NTP “Beni” Suharekë & OE “Aroma Plus”sh.p.k. Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Mirëmbajta e të gjitha objekteve Komunale dhe sigurimi i tyre**”, me nr. të prokurimit: 635/17/038/215, të shpallur nga autoriteti kontraktues– Komuna e Pejës, si e bazuar.
- I. **Anulohet**, vendimi i autoritetit kontraktues Komunës së Pejës, njoftim për dhënie të kontratës, për aktivitetin e prokurimit me titull: “**Mirëmbajta e të gjitha objekteve Komunale dhe sigurimi i tyre**”, me nr. të prokurimit: 635/17/038/215, dhe lënda kthehet ne Ri tenderim.
- II. Autoriteti Kontraktues në aftë prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me ketë prokurim.
- III. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin Shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së nr. 04/L-042, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues , që nuk respekton vendimin e Panelit Shqyrtues të paraparë me ketë ligj.

IV. Grupit të operatorëve ekonomik ankues “Selmans Network”sh.p.k. Prishtinë &OE“Krasniqi”sh.p.k. Prishtinë & OE“Schafberger gmbh”Drenas & OE NTP “Beni” Suharekë &OE “Aroma Plus”sh.p.k. Prishtinë, konform nenit 118 pika 3, i kthehen tarifa e sigurimit të ankesës.

V. Urdhërohen, OE ankues që konform nenit 36 pika 5 të Rregullores së Punës të OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Autoriteti kontraktues–Komuna e Pejës, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Mirëmbajta e të gjitha objekteve Komunale dhe sigurimi i tyre**”, me nr. të prokurimit: 635/17/038/215, ka aplikuar procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë.

Si kriter për dhënie të kontratës ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulet.

Kundër refuzimit të kërkesës për rishqyrtim, të dt. 13 prill 2017, grupi i operatorve ekonomik “Selmans Network”sh.p.k. Prishtinë &OE“Krasniqi”sh.p.k. Prishtinë & OE“Schafberger gmbh”Drenas & OE NTP “Beni” Suharekë &OE “Aroma Plus”sh.p.k. Prishtinë, në afatin e paraparë ligjor ka parashtruar ankesë në OSHP-së.

Pikat e ankesës:

Pala ankuese pretendon se autoriteti kontraktues me rastin e përdorimit të procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, për aktivitetin e prokurimit “**Mirëmbajta e të gjitha objekteve Komunale dhe sigurimi i tyre**”, me nr. të prokurimit: 635/17/038/215, ka bërë shkelje të nenit 6, nenit 7, nenit 8, nenit 10 dhe nenit 35 të LPP-së.

Ankesa e grupit të operatorëve ekonomik është e afatëshme dhe është parashtruar nga ana e personit kompetent.

Ankesa është e bazuar.

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 dhe 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, me datën 27 prill 2017, ka autorizuar eksperten shqyrtues, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja shqyrtues me datën 08 maj 2017, i dorëzon panelit shqyrtues raportin e ekspertizës, ku në raportin lidhur me pretendimin e operatorëve ekonomik ankues ku thuhet se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 6 të LPP-së, sqaron se autoriteti kontraktues është i obliguar që fondet publike dhe burimet publike të përdorë në mënyrë ekonomike, duke pasur parasysh qëllimin dhe lëndën e kontratës, prandaj autoriteti kontraktues në rast të kontraktimit të kontratës me vlerë me të lartë se kontrata e më hershme për këto shërbime, konform nenit 6 të LPP-së, ka përgjegjësi për mos shfrytëzim të drejt fondeve publike dhe burimeve publike.

Pretendimi i operatorëve ekonomik ankues ku thuhet: “*AK Komuna e Pejës gjithashtu ka bërë shkelje të LPP-së nënëtit 7, trajtim/Jo Diskriminimi, paragrafi 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6, nga që duke shpërblyer një operator me kontratë me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë ka eliminuar kështu nga konkurenca dhe nuk ka trajtuar të gjithë OE të cilët do të mund te paraqesin ofertat e tyre ne këtë procedurë te prokurimit*”, eksperjtja shqyrtues sqaron se pretendimi i operatorit ekonomik ankues është i bazuar përfaktin se autoriteti kontraktues në rastin konkret nuk ka respektuar nenin 7 paragrafi 2 të LPP-së ku thuhet: “autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik”, përfaktin se ftesën për pjesëmarrje në procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë ja ka bërë vetëm OE “KRM AMBIENTI”, kur dihet se në treg ka më shumë se një kompani të cilat ofrojnë shërbime të pastrimi dhe sigurimit në Republikën e Kosovë.

Pretendimi i operatorëve ekonomik ankues ku thuhet: “*AK Komuna e Pejës duke u munduar që të shpërblyej në mënyrë të kundërligjshme dhe të shpallë fitues KRM AMBIENTI është munduar që të përdorë si kriter një nga procedurat e lejuara të LPP-së, konkretisht nenin 35, Procedura e Negociuar pa Publikimin e Njoftimit të Kontratës, respektivisht ku ceket jemi të bindur se AK. Komuna e Pejës me rastin e Njoftimit apo jo të KRPP-së, nuk ka dhënë arsyë të qëndrueshme se pse ka përdorur këtë lloj të Procedurës së Prokurimit Publik*”, eksperjtja shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues përmes parashtrës me shkrim të dt. 21 mars 2017, në harmoni me nenin 35 paragrafi 1 të LPP-së, e ka njoftuar KRPP-në përpërdorimin e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë pëaktivitetin e prokurimit me titull: “**Mirëmbajta e të gjitha objekteve Komunale dhe sigurimi i tyre**”, me nr. të prokurimit: 635/17/038/215.

Pretendimi i operatorëve ekonomik ankues ku ndër të tjera thuhet: “*KRM AMBIENTI nuk ka as përvojën dhe as njojurinë e duhur për të kryer një lloj të tillë të shërbimeve e aq më pak për të kryer shërbimet e sigurimit fizik te Objekteve të Komunës së Pejës, kur dihet mirë përfakti se shërbimet të tillë kërkojnë licenca të cilat duhet të merren në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe në Policinë e Kosovës e për të cilat KRM AMBIENTI as që ka aplikuar ndonjëherë e lër më ti ketë*”, eksperjtja shqyrtues sqaron, autoriteti kontraktues në nenin III. 2.4 të FTD-së, te kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale ka kërkuar: Listën e shërbimeve të realizuar në tri vitet e fundit të kësaj lëmie se paku tri/3; Dëshmja dokumentare: Lista e kontratave të shërbimeve të ngjashme në tri vitet e fundit, ndërsa operatori ekonomik KRM “AMBIENTI”, si dëshmi ka ofruar vetëm një kontratë me Komunën e Pejës lidhur me

aktiviteti e prokurimit “Larja dhe fshirja e rrugëve, mirëmbajtja e varrezave, sipërfaqeve të gjelbëruar dhe ndriçimit”.

Bazuar ne atë që u tha më lartë, rezulton se operatori ekonomik KRM “AMBIENTI”, nuk e ka ofruar dëshmi ashtu siç është kërkuar në nenin III. 2.4 të FTD-së, ku thuhet: “Lista e kontratave të shërbimeve të ngjashme në tri vitet e fundit”.

Ndërsa sa i përket asaj ku thuhet ndër të tjera se *OE “KRM AMBIENTI” nuk ka përvojë aq me pak në shërbimet e sigurimit fizik te Objekteve të Komunës së Pejës, kur dihet mirë për fakti se shërbimet të tilla kërkojnë licenca të veçanta të cilat duhet të merren në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe në Policinë e Kosovës e për të cilat KRM AMBIENTI as që ka aplikuar ndonjëherë e lër më ti ketë, ekspertja shqyrtues duke pasur parasysh vlerën e parashkruar të kontratës si dhe përdorimin e drejtë të fondeve publike, vlerëson se në rastin konkret autoriteti kontraktues është dashur që në dosjen e tenderit, të parasheh edhe kërkesat minimale për kualifikim të operatorit ekonomik për shërbime të sigurimit, ashtu siç kërkohet edhe ne nenin 51 të LPP-së dhe në nenin 26 të Rregullat dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimi Publik, të cilat kërkesa janë drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës, më qëllim që të respektohet parim bazë i LPP-së, “Vlera për paranë”.*

Ekspertja shqyrtues bazuar ne atë që u tha më lartë, i propozon panelit shqyrtues ankesën e operatorëve ekonomik ankues ta aprovoj si të bazuar, ndërsa të anuloj vendimin- njoftimin për dhënie të kontratës të autoritetit kontraktues, të dt. 04 prill 2017, dhe lëndën ta kthej në Ri-tenderim.

Autoriteti kontraktues Komuna e Pejës dhe grupei i opatoreve ekonomik ankues edhe psë me dt. 08 maj 2017, ju është dërguar raporti i ekspertizës, nuk janë deklaruar se a pajtohen apo jo me mendimin e ekspertit shqyrtues të dhënë në raportin e ekspertizës së dt. 08 maj 2017.

Me rastin e procedurës para këtij organi u prezantuan provat duke e bërë kontrollimin dhe analizën e materialit të këtij aktiviteti të prokurimit i cili përbëhet: nga autorizimi i këtij aktivitetit, njoftimi i dt. 21 mars 2017, në KRPP-në për përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e grupit të operatorëve ekonomik ankues, si dhe raporti i ekspertit shqyrtues i dt. 08 maj 2017.

Ekspertja shqyrtues znj. Bullatovci, deklaroj: pretendimet ankimore si dhe përgjigjet në pretendimet ankimore i gjeni detajisht të përshkruara në raportin e ekspertizës së dt. 08 maj 2017.

Pretendimi i operatorit ekonomik ku thuhet se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 6 të LPP-së, paneli shqyrtues konstatoj se qëndron pretendimi i operatorit ekonomik ankues, për faktin se autoriteti kontraktues është i obliguar që fondet publike dhe burimet publike të përdorë në mënyrë ekonomike, duke pasur parasysh qëllimin dhe lëndën e kontratës, prandaj autoriteti kontraktues në rast të kontraktimit të kontratës me vlerë me të lartë se kontrata e më hershme për këto shërbime, konform nenit 6 të LPP-së, ka përgjegjësi për mos shfrytëzim të drejt fondeve publike dhe burimeve publike.

Pretendimi i operatorëve ekonomik ankues ku thuhet se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP-së, paneli shqyrtues sqaron se pretendimi i operatorëve ekonomik ankues është i bazuar për faktin se autoriteti kontraktues në rastin konkret nuk ka respektuar nenin 7 paragrafi 2 të LPP-së ku thuhet: "autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik", përfaktin se ftesën për pjesëmarrje në procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë ja ka bërë vetëm OE "KRM AMBIENTI", kur dihet se në treg ka më shumë se një kompani të cilat ofrojnë shërbime të pastrimi dhe sigurimit në Republikën e Kosovë.

Pretendimi i operatorëve ekonomik ankues ku ndër të tjera thuhet: “*KRM AMBIENTI nuk ka as përvojën dhe as njohurinë e duhur për të kryer një lloj të tillë të shërbimeve e aq më pak për të kryer shërbimet e sigurimit fizik te Objekteve të Komunës së Pejës, kur dihet mirë për fakti se shërbimet të tillë kërkojnë licenca të veçanta të cilat duhet të merren në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe në Policinë e Kosovës e për të cilat KRM AMBIENTI as që ka aplikuar ndonjëherë e lër më ti ketë*”, paneli shqyrtues sqaron qëndron pretendimi i operatorëve ekonomik ankues për arsyen se operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk ka ofruar dëshmi ashtu siç janë kërkuar në nenin III. 2.4 të FTD-së, te kërkesat mbi mundësít tekniqe dhe profesionale, ku është kërkuar: Listën e shërbimeve të realizuar në tri vitet e fundit të kësaj lëmie se paku tri/3; Dëshmia dokumentare: Lista e kontratave të shërbimeve të ngjashme në tri vitet e fundit, ndërsa operatori ekonomik KRM “AMBIENTI”, si dëshmi ka ofruar vetëm një kontratë me Komunën e Pejës lidhur me aktiviteti e prokurimit “Larja dhe fshirja e rrugëve, mirëmbajtja e varrezave, sipërfaqeve të gjelbëruar dhe ndriçimit”.

Pretendimi i operatorëve ekonomik ankues ku thuhet ndër të tjera se *OE “KRM AMBIENTI” nuk ka përvojë aq me pak në shërbimet e sigurimit fizik te Objekteve të Komunës së Pejës, kur dihet mirë për fakti se shërbimet të tillë kërkojnë licenca të veçanta të cilat duhet të merren në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe në Policinë e Kosovës e për të cilat KRM AMBIENTI as që ka aplikuar ndonjëherë e lërmë ti ketë*, paneli shqyrtues bazuar ne sqarimet e dhëna nga ekspertja shqyrtues, sqaron se duke pasur parasysh vlerën e parashkruar të kontratës si dhe përdorimin e drejtë të fondeve publike, vlerëson se në rastin konkret autoriteti kontraktues është dashur që në dosjen e tenderit, të parasheh edhe kërkesat minimale për kualifikim të operatorit ekonomik për shërbime të sigurimit, ashtu siç kërcohët edhe ne nenin 51 të LPP-së dhe në nenin 26 të Rregullat dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimi Publik, të cilat kërkesa janë drejtpërdrejtë relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës, më qëllim që të respektohet parim bazë i LPP-së, *“Vlera për paranë”*.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, dosjes së tenderit, konstatimeve të cekura në raportin e ekspertizës së ekspertes shqyrtues, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesit të ankesës, konstatoj se autoriteti kontraktues gjatë zhvillimit të aktivitetit të prokurimit me titull: “**Mirëmbajta e të gjitha objekteve Komunale dhe sigurimi i tyre**”, me nr. të prokurimit: 635/17/038/215, nuk ka respektuar dispozitat e LPP-së.

Paneli shqyrtues nga provat e prezantuara më lart, konform nenit: 117 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendim.

KSHILLA JURIDIKE :

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa,
por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet
Gjykatës Themelore-Departamentit për Çështje Administrative
për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 ekzemplar – OE “Selmans Network”sh.p.k. Prishtinë & OE “Krasniqi”sh.p.k. Prishtinë & OE “Schafberger gmbh”Drenas & OE NTP “Beni” Suharekë & OE “Aroma Plus”sh.p.k. Prishtinë
1x1 ekzemplar - AK- Komuna e Pejës
1x1 ekzemplar – Arkivës së OSHP-së